

**AKTI I THEMELIMIT I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AR-ZA GROUP” SHPK**

Une ortaku i vetem i shoqërisë:

- **Agron Enver Daci** lindur më 25,09,1975 në Lac (Kruje) shtetas Shqiptar, dhe banues në rr “Medar Shtylla” pall: Hawaii, nr.4, identifikuar me kate identiteti Nr. 027697629;

kam vendosur të nënshkruaj këtë Akt Themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“AR-ZA GROUP” SHPK**, aktiviteti i së cilës do të rregullohet nga ligji shqiptar në fuqi dhe nga Statuti i saj, pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

**Neni 1
Emri Dhe Forma e Shoqërisë**

Emri i shoqërisë është **“AR-ZA GROUP” SHPK**, në vijim referuar si “Shoqëria”.

- 1.1 Shoqëria themelohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjit shqiptar, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 2
Selia, Logoja Dhe Vula E Shoqërisë**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja “Aksioni”, Bulevardi “ Elez Isufi “, kati i pare i godines me nr. regjistri 14/248/1, zona kadastrale nr.2932 Peshkopi, Shqipëri. Organi i Administrimit ka të drejtë të vendosë hapjen dhe mbylljen e degëve dhe/ose zyrave të përfaqësimit.

- 2.2 Shoqëria do të ketë logon dhe vulën e saj. Vula do të përdoret ekskluzivisht nga Administratori i Vetëm i Shoqërisë.

- 2.3 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është një afat të papërcaktuar.

**Neni 4
Objekti i Shoqërisë**

Shoqëria ka si objekt kryesor zhvillimin e aktiviteteve të mëposhtme:

- 4.1 Instalimi, mirëmbajtje e projektimin për llogari të saj dhe të tretëve ose edhe me nënkontraktim të impianteve civile dhe industriale, impiante të transportit e të dhënave, impiante radiotelevizioni dhe elektronike të llojit të instalimit të antenave dhe impiante të mbrojtjes nga rrufetë, impiante ngrohje dhe klimatizimi, impiante të ngritjes së personave ose gjërave nëpërmjet ashensorëve, shkallëve mekanike, impiante mbrojtje kundër zjarrit, impiante sanitare duke përfshirë edhe kanalizime të ujrave të zeza.


Agron Daci

- 4.2 Ndërtime civile për ente private ose publike me tenderim ose nën tenderim, të cilat janë: ndërtesa civile ose industriale, rrugë, ujëmbledhës, rrjetë ujrash të zeza dhe shërbimi karpentierie etj.
- 4.3 Import-Eksport, Tregëti me shumicë e pakicë të çfarëdolloji produkti apo materiali që përmban sektori i ndërtimit, energjise, bujqesise, tekstile etj.
- 4.4 Aktivitet marketing, kurse formim profesional, konsulence etj.
- 4.5 Aktivitet për transport malli për të tretë, menaxhim i magazinave të mallrave të ndryshëm, dërgim, paketim.
- 4.6 Shoqëria për arritjen e qëllimit të objektit të saj mund të realizojë të gjitha operacionet mobiliare dhe imobiliare, financiare të përputhshme me objektin e shoqërisë. Mund të marrë si në Shqipëri ose jashtë Shqipërisë, kuota/aksione në shoqëri ose aktivitete juridike si të përkohëshme të përputhshme ose analoge me objektin e shoqërisë, por me kusht që pjesmarrja mos ndryshojë me objektin e shoqërisë.
- 4.7 Mund të blejë kredi dhe në përgjithësi në mbështetje të çfarëdolloji forme financimi me institute kreditimi, banka, shoqëri ose individë të cilët japin garancitë mobiliare dhe imobiliare, reale dhe personale.
- 4.8 Shoqëria mund të japë garanci të përgjithëshme në favor të tretë.
- 4.9 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmës që ka si qëllim ofrimin e çdo shërbimi tjetër dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjetër, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit kryesor.
- 4.10 Me qëllim realizimin e objektit të saj, me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme, Shoqëria mund të zotërojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, aksione ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja.
- 4.11 Shoqëria, me miratimin e Organit të Administrimit dhe me qëllim realizimin e objektit të saj, mund të marrë pjesë në çfarëdolloj marrëveshje tregtare dhe/ose joint venture me shoqëri dhe ndërmarrje të tjera si edhe të kryejë çdo akt tjetër të nevojshëm. Shoqëria mund të lidhë kontrata qiraje, shitblerje, marrëveshje për vendosje hipoteke mbi pasuri të paluajtshme, marrëveshje huadhënie ose financimi, marrëveshje për ofrimin e shërbimeve dhe çdo marrëveshje tjetër që konsideron të nevojshme dhe/ose të dobishme për përmbushjen e objektit të saj.

Neni 5

Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100000 Lekë (njëqind mijë), i ndarë në një kuote të vetme ku vlera nominale e një kuote është 100000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm i cili është i paguar plotësisht nga:

Agrou Daci 

- Ortaku themelues **Agron Enver Daci** i cili zotëron 100 % pjesë të kapitalit të shoqërisë me vlerë 100000 lekë;

Neni 6 **Administrimi i shoqërisë**

Asambleja e Përgjithshme zgjedh një person fizikë si Administratorë të Vetëm të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare me të drejtë rizgjedhje, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimi do të jetë individualë dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator. Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorit parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administratorë i parë i shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rinovimi.

Të dhënat e identifikimit:

- **Agron Enver Daci** lindur më 25,09,1975 në Lac (Kruje) shtetas Shqiptar, dhe banues në rr "Medar Shtylla" pall: Hawaii, nr.4, identifikuar me kate identiteti Nr. 027697629;

Neni 7 **Dispozita mbi organizimin**

Parashikimet mbi organizimin, si edhe rregullat në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe çështjeve të brendshme të saj, parashikohen në Statutin e Shoqërisë.

Neni 8 **Gjuha**

Ky Akt Themelimi hartohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën Shqipe, me të njëjtën vlerë.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut Themelues:

Agron Enver Daci

Agron Daci